



## Përmbajtja:

- Njohtim nga Drejtori Ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së
- Takimi i dytë zgjedhor i AKK-së më 29 Tetorë 2003
- AKK-ja në takimin e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës
- Prona Komunale dhe Menaxhimi i saj
- Grupet Analizuese të AKK-së
- Vizita e Kryetarit të New York-ut Kosovës
- Takimi i Këshillit të AKK-së me 16 Dhjetor 2003
- Projekti i Agjencionit Evropian në përkrahje të AKK-së

# Buletini Informativ i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)

## Njohtim

Të nderuar miq,

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) prej muajit Janar, 2004 fillon me publikimin e Buletinit Informativ.

AKK-ja është formuar më 30 Qershor 2001 dhe është prezentues i interesave të të gjitha Komunave të Kosovës. Asociacioni angazhohet që në Kosovë të implementohen rregullat nga Karta Evropiane për qeverisjen lokale. AKK ka Statutin, Objektivat dhe Strategjinë e punës për realizimin e objektivave të veta. AKK-ja ka Kryetarin, Nën-Kryetarin, Bordin drejtues të AKK-së si dhe Kuvendin. Kuvendi i AKK-së përbëhet nga anëtarët e Kuvendeve Komunale ku përfaqësimi i çdo komune bëhet sipas sistemit 1 delegat për 10 anëtarë të zgjedhur në Kuvendin Komunal. Duhet të theksohet se AKK-ja është organizatë jo politike dhe multi etnike.

Qëllimi i këtij Buletini është informimi i Komunave si dhe Organizatave vendore dhe ndërkombëtare lidhur me aktivitetet dhe punën e AKK-së gjatë periudhës një mujore. Përveç publikimeve të punës dhe aktiviteteve të AKK-së, në Buletin do të ketë hapësirë edhe për aktivitete të rëndësishme të Komunave të Kosovës si dhe intervista me Kryetarët e Komunave të Kosovës.

Për momentin AKK-ja është në procesin e rritjes së kapacitetit të vet.

Gjatë muajit Shkurt—Mars 2004, pritet kompletimi i personelit Administrativ të AKK-së. Në Buletinin e parë do të paraqiten disa nga aktivitetet më të rëndësishme të AKK-së të vitit 2003.

Mbetem me shpresë që në të ardhmen, Buletini Informativ do të jetë një instrument shumë i rëndësishëm për promovimin e punës së AKK-së dhe Komunave të Kosovës në përgjithësi si dhe informimin e qytetarëve të Kosovës lidhur me punën e AKK-së dhe të Komunave të Kosovës.

Sazan Ibrahim

Drejtori Ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së,

## Takimi i dytë zgjedhor i AKK-së

Më 29 Tetor të vitit 2003 është mbajtur Takimi i Dytë Zgjedhor i AKK-së ku morën pjesë Kryetar dhe anëtarë të Komunave të Kosovës si dhe mysafir nga Institucionet Vetë-qeverisëse të Kosovës, nga Këshilli i Evropës, Zyrat Diplomatike në Kosovë, OSBE-ja si dhe Agjencioni Evropian për Rindërtim.

Në emër të Kongresit të Autoriteteve Komunale dhe Regjionale të Evropës, takimin e përshëndeti Z. Yavus Mildon – Zëvendës Kryetar i Kongresit, i cili theksoi se AKK-ja është anëtar në Këshillin e Evropës, Kongresin e autoriteteve Regjionale dhe Lokale ku ka pozitën e vëzhguesit dhe se këtë pozitë do ta ketë deri sa komuniteti ndërkombëtar të jetë prezent në Kosovë.

Z. Fridheml Frischenschlager, OSBE/ Drejtor Departamentit për Demokratizim po ashtu përshëndeti takimin duke vlerësuar punën e AKK-së si shumë të rëndësishme dhe njëkohësisht i dëshiroj fat AKK-së në punën e saj në të ardhmen.

Z. Alan Packer-Udhëheqës i ekipit të IFES-it për përkrahje të AKK-së gjithashtu përshëndeti punimet e Kuvendit të AKK-së ku me këtë rast ai theksoi rolin e IFES Ltd në përkrahjen e AKK-së dhe rolin e AKK-së në demokratizimin e shoqërisë në Kosovë.

Z. Lutfi Haziri, Kryetar i AKK-së paraqiti para të pranishmëve punën e AKK-së gjatë vitit 2003 si dhe objektivat e AKK-së për të ardhmën. Gjithashtu Z. Haziri prezantoi raportin vjetor dhe atë financiarë të vitit 2003.



---

*Më 24-25 Nëntorë 2003,  
në Strazburg të Francës  
është mbajtur takimi i  
radhës i Kongresit të  
Autoriteteve Lokale dhe  
Regjionale të Evropës, ku  
AKK-ja ka statusin e  
vëzhguesit.*

---

Kuvendi me vota të hapura bëri zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të AKK-së ku, anëtarë të ardhshëm të Bordit të AKK-së u zgjedhën:

- Z. Lutfi Haziri –Kryetar i Komunës së Gjilanit (LDK)
- Z. Ismet Beqiri- Kryetar i Komunës së Prishtinës (LDK)
- Z. Faruk Spahija - Kryetar i Komunës së Mitrovicës (LDK)
- Z. Ramadan Gashi - Kryetar i Komunës së Skënderajit (PDK)
- Z.Fehmi Mujota - Kryetar i Komunës së Shtimes (PDK)
- Z.Mazllum Kumnova-Anëtarë i Kuvendit Komunal të Gjakovës (AAK)

Për Kryetar respektivisht Nën-Kryetar të AKK-së për mandatin e ardhshëm u zgjedhën unanimisht Z. Lutfi Haziri- Kryetar, përkatësisht Z. Ramadan Gashi-Nën-Kryetar.

Në fund të takimit, Kuvendi i AKK-së shpalli Kryetar Nderi të Asociacionit të Komunave të Kosovës të ndjerin Z. Ukë Bytyqi, ish-Kryetar i Komunës së Therandës dhe njëherit njëri nga themeluesit të AKK-së.

Gjithashtu, Kuvendi I AKK-së dënoi rastin e incidentit që ndodhi në fshatin Prekaz, Komuna e Skënderajt, kur KFOR-i françes provokoi familjen Jashari, dhe kërkoi që në të ardhmen këso rastesh të mos përsëriten.

---

## **AKK-ja në takimin e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës - Sesioni Vjeshtor**

Më 24 – 26 Nëntorë 2003, në Strasburg të Francës është mbajtur takimi i radhës i Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës. Në këtë takim delegacioni Kosovar i përbërë nga: Z. Lutfi Haziri- Kryetarë i AKK-së, Z. Fehmi Mujota – anëtarë i Bordit të AKK-së, Z. Sazan Ibrahim – Drejtor Ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së dhe Z. Alan Packer – Këshilltar Ndërkombëtar i AKK-së e përfaqësuan Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Pasi që takimi ishte dy ditore, disa nga pikat më të rëndësishme që u diskutuan në këtë takim janë:

- Rrjeta e Asociacioneve të Kryeshefave Ekzekutiv
- Sesioni pranveror i CLRAE-së është vendosur të mbahet më 22-24 Mars të vitit 2004
- Raporti mbi Demokracinë Lokale në Armeni
- Liberalizimi i ujësjellësit në Evropë
- Drafti i Kartës Evropiane mbi vetë qeverisjen Regjionale
- Përkrahja e punës së Këshillit të Evropës mbi Reformat në Kosovë
- Inkurajimi i dialogut Prishtinë – Beograd

Në pjesën e dytë të takimit të ditës së dytë, Procesi i Reformave në Kosovë si dhe Raporti i Këshillit të Evropës ishin temë për diskutim.

Z. Mildon tregoi se përfaqësuesit e zgjedhur Kosovarë e kanë indikuar atë (Z. Mildon) se Këshilli i Evropës, Misioni i Decentralizimit nuk është konsultuar sa duhet lidhur me këtë proces me përfaqësuesit e zgjedhur Kosovar.

Ne duhet të kemi diskutime lidhur me këtë çështje në kongresin e Këshillit të Evropës –tha ai.

Z. Masters theksoi disa probleme në Ballkan dhe përkrahu raportin e Këshillit të Evropës mbi Reformat në Kosovë.

Pas kësaj z. Lutfi Haziri në emër të delegacionit Kosovar mori fjalën dhe në fillim përhëndeti përzemësisht të gjithë të pranishmit dhe veçanërisht z. Yavus Mildon dhe Z. Owen Masters për punën dhe Kontributin e dhënë në Kosovë dhe pastaj lexoi Deklaratën mbi Rekomandimet e Këshillit të Evropës Misionit të Decentralizimit. Kjo deklaratë zgjoi një interesim të madh dhe u cilësua me rëndësi të veçant.

Deklarata e lexuar në Strazbourg iu është shpërndarë Komunave të Kosovës nëpërmes Kryetarëve në Takimin e Këshillit të Kryetarëve në 16 Dhjetorë 2003.

## Prona Komunale dhe Menaxhimi i saj

Viti 2003 ishte viti kur filloi procesi i Privatizimit në Kosovë. Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit është organi i cili është duke e kryer këtë proces. Ndërrmarjet Shoqërore dhe ato publike do të privatizohen në bazë të procesit të

- Spinn-off dhe
- Falimentimit.

Me këtë rast, Komunave të Kosovës iu është marrë e drejta e Menaxhimit të Pronës Komunale.

Kjo e drejtë iu është marrë në mënyrë arbitrare nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit. Për këtë arsye AKK-ja ka reaguar ndaj marrjes së kësaj të drejte. Deklarata parimore "Menaxhimi i Pronës Komunale" e cila është bërë publike nga AKK-ja, nxorri në pah mosknaqësinë e Komunave të Kosovës lidhur me menaxhimin e pronës komunale si dhe problemet me të cilat Komunitat do të ndeshen në të ardhmen për shkak të mospërfilljes së Komunës si Insitucion legjitim i cili përfaqëson dhe mbron të drejtat e qytetarëve të vet.

Në lidhje me këtë, grupi punues i AKK-së mbi Pronën Komunale u takua me personalitetet më të larta të Kosovës si dhe me Z. Francesco Bastagli, Z/PSSP për Administratë Civile.

Në lidhje me pronën komunale dhe privatizimin, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka tri porosi kyçe:

- Privatizimi është i domosdoshshëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës
- Komunitat kanë të drejtë të konsultohen në lidhje me privatizimin e ndërrmarjeve që gjenden brenda kufirit të tyre komunal.
- Komunitat kanë të drejtë të kundërshtojnë raste të veçanta ku interesat e tyre legjitime janë të cenuara

## Grupet Analizuese (punuese) të Asociacionit të Komunave të Kosovës

IFES Ltd, e cila është duke e përkrahur Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) në zhvillimin e saj, në kooperim të ngushtë me AKK-në ka organizuar një varg takimesh me grupe analizuese (grupe punuese). Grupet analizuese përbëhen nga nëpunësit civil komunal si dhe nga anëtar të Kuvendeve Komunale. Në këto takime është diskutuar për çështje të cilat janë me rëndësi të veçantë për Komunitat. Me ndihmën e IFES Ltd janë sjellur ekspertë ndërkombëtar të cilët së bashku me grupet punuese të AKK-së kanë hartuar deklarata parimore. Duke filluar që nga fundi i vitit 2003 e deri më tani janë hartuar deklaratat parimore lidhur me Reformat Administrative, Shërbimet Publike dhe Zhvillimin Ekonomik Lokal.

Pas përpilimit të deklaratave parimore nga grupet analizuese, Këshili i AKK-së do të debatohet dhe nëse këto deklarata i përmbushin standardet, atëherë edhe do të aprovohen si deklarata parimore të AKK-së.


Pas aprovimit, deklaratat do të shpërndahen nëpër komuna dhe pastaj do të filloi procesi i konsultimeve me Kuvendet Komunale. OSBE-ja ka ofruar ndihmën e tyre në lidhje me prezentimin e materialit në Kuvendet Komunale.

Është me rëndësi të theksohet se IFES Ltd. ka sjellur ekspertë të cilët janë me eksperiencë në vendet e tyre dhe se me përvojën e tyre kanë kontribuar shumë në zhvillimin dhe përpilimin e deklaratave parimore.

## Takimi i Kryetarëve të Komunave me Kryetarin e New York-ut

Më 23 Nëntor 2003 në Kosovë arriti për vizitë njëditore Kryetari i New York-ut Z. Bloomberg. Përveç takimeve që pati me Kryetarin e Kosovës, Z. Ibrahim Rugova si dhe me Kryeministrin e Kosovës, Z. Bajram Rexhepi, Z. Bloomberg pati takim të veçant me Z. Ismet Beqiri, Kryetarin e Komunës së Prishtinës dhe njëherit anëtar i Bordit të AKK-së. Gjithashtu, për nder të Z. Bloomberg u organizua një koktel rasti ku me këtë rast Kryetarët e Komunave të Kosovës ishin prezent.





Lokacioni i zyrës së re së  
Asociacionit:

- 1) Zyra e Re
- 2) Përmendorja
- 3) Ish ndërtesa e Sllovenia Sportit
- 4) Zyra e vjetër


Rr. Robert Gajdiku, Nr.113

Tel: 038/ 248 941

Fax: 038/ 248 941

Email:

komunat\_akk@hotmail.com



Statusin e  
Vëzhguesit

## Takimi i Këshillit të AKK-së më 16 Dhjetor 2003

Asociacioni i Komunave të Kosovës mbajti takimin e parë pas zgjedhjeve të dyta të Tetorit. Ky takim u mbajt në Hotelin 'Grand' më 16 Dhjetorë 2003.

Në këtë takim morrën pjesë Kryetar dhe Nënkryetar të Komunave të Kosovës si dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme si: OSBE-ja, UNDP, USAID, etj.

Në fillim Z. Lutfi Hazir, Kryetar i AKK-së përshëndeti të pranishmit dhe i uroi Komunës së Ferizajt 130 vjetorin e themelimit.

Në vazhdim të takimit Z. Sazan Ibrahim, Drejtori Ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së paraqiti disa nga projektet më të rëndësishmetë të AKK-së për vitin 2004. Disa nga projektet e AKK-së janë: Krijimi i web faqes së AKK-së dhe komunave të Kosovës, Hulumtimi mbi "Sa Komunitat e Kosovës i kanë përmushur Standardet e paraqitura nga Komuniteti ndërkombëtar", dy vizita pune në vendet ballkanike, angazhimi i kryeshefave ekzekutiv në Kuadër të AKK-së. Përveç kësaj, AKK-ja do të organizojë tryeza të rrumbullakëta lidhur me temat që i preokupojnë Komunitat e Kosovës.

Me përkrahjen e Agjencionit Evropian për Rindërtim, ku IFES-i është implementues ka edhe projekte të tjera, si Grupet Analizuese të cilat punojnë lidhur me preokupimet e Komunave Kosovare.

Në këtë takim po ashtu është diskutuar për regjistrimin civil dhe të bizneseve. Kryetarët e Komunave janë ankuar se kjo kompetencë nuk i takon Komunave edhe pse kjo sipas standardeve Evropiane duhet t'i takojë. Në këtë takim Kryetarët kërkuan unanimisht që këto Kompetenca duhet t'ju rikthehen komunave dhe se Komunitat duhet t'i ushtrojnë këto kompetenca shumë më mirë se sa dikush tjetër. Në lidhje me këtë temë, Kryetari i Komunitetit të Prishtinës Z. Ismet Beqiri shprehu shqetësime të shumta dhe tha se papërgjegjësia e punëtorëve të dikujt tjetër siç po ndodh me Regjistrimin Civil po bie mbi Komunitat edhe pse kjo nuk i takon Komunave. Komunitat tona po kritikohen, e në realitet Komunitat vetëm i kanë lëshuar zyret për këtë çështje. Tatimi mbi pronë ishte njëra ndër pikat e cila u diskutua në këtë takim. Z. Lutfi Haziri theksoi se inkasimi i Komunave nga ky tatim është shumë i vogël. Do të ishte mirë që të bëhet unifikim i politikave nga të gjitha komunitet që të bëhet presion më i madh ndaj qytetarëve lidhur me pagesën e këtij tatimi. Emërtimi i vendbanimeve është një çështje shumë e rëndësishme për Komunitat. Këshilli i AKK-së përkrah emërtimet e vendbanimeve të cilat janë të caktuara me Statutet Komunale.

## Projekti i Agjencionit Evropian

Projektet nga Agjencioni Evropian për Rindërtim kontribuojnë për qëllime të larta shoqërore që nxisin zhvillimin e Kosovës. Në sektorin e 'qeverisjes së mirë' për këtë projekt është përcaktuar synimi vijues:

*"Të kontribuojë për ndërtimin e një Kosove demokratike, me institucione të forta dhe efektive, që i respektojnë të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, duke i shërbyer në të njëjtën kohë të gjithë popullatës në një mënyrë efektive, të drejtë dhe pluraliste".*

Titulli i projektit është 'Mbështetje decentralizimit në nivelin komunal' dhe organizata kryesore për këtë projekt është Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK).

Si implementues të këtij projekti është organizata IFES Ltd. Përveq mbështetjes së AKK-së IFES Ltd do të punojë po ashtu me Grupe Analizuese të cilat do të punojnë në lidhje me preokupimet e shumta të Komunave. Deri më tani këto grupe kanë punuar në lidhje me :

- Reformat Administrative
- Shërbimet Publike
- Zhvillimin Ekonomik